

# Lëshimi i pasaportës biometrike

## Përshkrimi

Pajisja e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike për jashtë shtetit, që kanë mbushur moshën 16 vjeç dhe kanë të drejtën të pajisen me kartë identiteti.

## Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Kartë identiteti, dhe/ose
- 2) Pasaportë e modelit të vjetër, dhe/ose
- 3) Certifikatë lindjeje ose certifikatë familjare;
- 4) Në mungesë, çdo dokument tjetër i vlefshëm me fotografi lëshuar nga vendi pritës;
- 5) Kuponi për pasaportën ose konferma për kryerjen e pagesës në llogarinë e përfaqësisë.

## Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale dhe verifikimi i identitetit;
- 2) Konfirmimi i të dhënave me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- 3) Marrja e fotos dixhitale;
- 4) Skanimi dhe marrja e shenjave të gishtërinjve;
- 5) Depozitimi i nënshkrimit elektronik;

## Tarifa e shërbimit dhe afati

- 1) Greqi, Itali :130 euro,
- 2) Bruksel: 170 euro,
- 3) Angli: 144 paund,
- 4) Zvicër: 204 franga,
- 5) SHBA: 240\$

Afati i shërbimit është 28 ditë.

## Zyra

- 1) Ambasadat e RSH: Athinë; Romë; Londër; Bernë.
- 2) Konsullatat e Përgjithshme: Selanik; Milano.
- 3) Zyra konsullore: Nju Jork.

## Shënime

Vlefshmëria e pasaportave është 10 vjet.

Tërheqja e pasaportës bëhet nga vetë personi ose një përfaqësues i caktuar me prokurë.